Assesi mos nënvlerëso asnjë gjë, edhe po e takove vëllanë tënd me fytyrë të buzëqeshur

Ebu Dherri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton: "Profeti ﷺ më ka thënë: "Assesi mos nënvlerëso asnjë gjë, edhe po e takove vëllanë tënd me fytyrë të buzëqeshur."
[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti ﷺ në këtë hadith na inkurajon për të bërë mirë dhe për të mos e nënvlerësuar atë, qoftë dhe e paktë. Kjo përfshin fytyrën e çelur e me buzëqeshje gjatë takimit, kështu që muslimani duhet të ketë kujdes për të, për shkak të dashamirësisë ndaj vëllait musliman dhe se e bën atë të lumtur.

https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/5348